




KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë



MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Neni 1

Palët nënshkruese të këtij memorandumi:

1. Kolegji BIZNESI-Prishtinë, rruga "Motrat Qiriazhi" nr 29 të cilën e përfaqëson Dr. Shyqeri Kabashi -Dekan, dhe
2. Zhuri sh.p.k., Adresa: *Tranziti* p.n. Prizren R. e Kosovës, me NRB 810974114.

Neni 2

Qëllimi i këtij Memorandumi

Ky Memorandum bashkëpunimi ka për qëllim përcaktimin e fushave të bashkëpunimit, kushteve dhe afatet themelore, në bazë të të cilave Kolegji BIZNESI- Prishtinë dhe Zhuri sh.p.k.-Prizren, pajtohen për bashkëpunim.

Neni 3

Fushat e bashkëpunimit

1. Zhuri sh.p.k. -Prizren do të ndihmojë dhe mbështesë në vazhdimësi Kolegjin Biznesi, në pranimin e studentëve për realizimin e praktikës, dhe dhënjën e sygjërimeve për nevojat e ekonomisë së tregut si pal e interesit nga jashtë, të bazuar në politikat e këtij institucionit.
2. Kolegji Biznesi do të mbështesë në vazhdimësi Zhuri sh.p.k. -Prizren në aspektin e trajnimeve në fushat: **Menaxhimi i emergjencave** (mbrojtjes nga zjarrit duke kontrolluar dhe servisuar aparataturat për shuarjen e zjarrit), **Ekonomisë** (hartimin e pasqyrave financiare dhe planit të biznesit), **Juridike** (hartimi i kontratave dhe rregulloreve) dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale të personelit.
3. Kolegji Biznesi do të mbështesë, Zhuri sh.p.k. -Prizren me stafin e sajë akademik, për ligjërata nga lëmia: Emergjencave, Ekonomisë dhe Jurisprudencës-sipas nevojave që paraqet Zhuri sh.p.k.

Neni 4

Interpretimi dhe ndryshimi i memorandumit

1. Interpretimi i këtij Memorandumi do të bëhet në pajtim me Ligjet e Kosovës, duke e ruajtur parimin e reciprocitetit.
2. Afati i këti memorandumi është në kohë të pacaktuar. Ndryshimet dhe plotësimet e këti Memorandumi mund të bëhen vetëm me shkrim dhe të nënshkruara nga të dyja palët.

Neni 5

Kopjet e Memorandumit

Memorandumi është punuar në katër kopje origjinale, nga dy kopje për secilën palë.


Neni 6

Hyrja në fuqi

Ky Memorandum hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët.


PALËT NËNSHKRUESE

Kolegji BIZNESI, Prishtinë


/Prof. Dr. Shyqeri Kabashi/
D e k a n



ZHURI SH.P.K..


/Qëndrim Susuri/
Drejtor



Nënshkruar në Prishtinë, me datë 03 / 12 /2020